

**VENDIM**  
**Nr. 827, datë 26.12.2024**

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AGJENCINË E ZHVILLIMIT TË  
TERRITORIT PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), për vitin 2025, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Të ardhurat e krijuara nga AZHT-ja deri në fund të vitit 2024 trashëgohen në vitin buxhetor 2025 dhe përdoren nga AZHT-ja për mbulimin e kostove dhe shpenzimeve të veta.
3. Të ardhurat e arkëtuara deri në fund të vitit 2024 transferohen në llogarinë bankare të AZHT-së, në bankën e nivelit të dytë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2025.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**PASQYRA NR. 1**  
**PLANI I TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË  
TERRITORIT PËR VITIN 2025**

| <b>Lekë</b>                                                               | <b>BUXHETI 2025</b>   |                       |
|---------------------------------------------------------------------------|-----------------------|-----------------------|
|                                                                           | <b>Të ardhurat</b>    | <b>Shpenzimet</b>     |
| <b>PËRSHKRIMI</b>                                                         |                       |                       |
| Të ardhura të planifikuara për t'u mbledhur (2025)                        | 11 000 000 000        |                       |
| Të ardhura të akumuluar në vitin 2024                                     | 379 796 043           |                       |
| Shpenzime personeli dhe shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore |                       | 316 000 000           |
| Shpenzime korente të tjera                                                |                       | 38 796 043            |
| Shpenzime kapitale                                                        |                       | 25 000 000            |
| <b>Total AZHT</b>                                                         | <b>11 379 796 043</b> | <b>379 796 043</b>    |
| <b>Të ardhura të pashpërndara (të ardhura – shpenzime)</b>                |                       | <b>11 379 796 043</b> |